

FJALA E DEPUTETES MERITA BAKIU

E HËNË 6 QERSHOR 2022

E nderuar drejtuese e seancës,

Të dashur qytetarë që na ndiqni,

Megjithëse me një karrierë të gjatë politike lokale, si deputete e re në parlament dua ta shfrytëzoj këtë podium vetëm në funksion të votueseve. Ashtu sikurse kam pritur dhe shpresuar sa herë që kam qenë në pozicionin tuaj, unë nuk mund të hesht ndërsa konstatoj varfërinë dhe kjo nuk është hiperbolë. Shqiptarët sot janë më të varfër se dje, më të varfër se para një viti dhe më të varfër se gjatë gjithë kohërave të fundit.

Çdo shqiptari i duhet të paguajë sot 250 lekë litrin e naftës, i cili është një çmim abuzues dhe arbitrar, produkt i një vendimi të bordit të transparencës, organizmit mafioz shtetëror, i cili po vjedh çdo ditë para në kurriz të qytetarëve shqiptarë. Ai nuk është një bord transparence, por një bord plaçkitës, i cili vepron për interesat personale të Edi Ramës dhe të miqve të tij klientelistë. Shqipëria jonë, vendi që ne mendojmë për të ardhmen e fëmijëve, sot është më e varfër se kurrë. Tkurrja e ekonomisë dhe niveli i lartë i çmimeve e rrit çdo ditë numrin e familjeve të varfra dhe në minimumin jetik të jetesës. Pjesa më e madhe e popullsisë shqiptare jeton sot me të ardhura për frymë në kufi të varfërisë ekstreme, vetëm me 5 dollarë në ditë.

Numri i personave që jetojnë me më pak se 5,5 dollarë në ditë ka arritur në 622 000 në vitin 2021. Shifra tregon se 1 në 5 persona janë të varfër në Shqipëri. Shqipëria kryeson me nivelin më të lartë të varfërisë në rajon. Por, si mund t'i çojmë treguesit e varfërisë në trend rënieje?! Në një vend normal, me një qeveri normale kjo rregullohet me rritjen e ndihmës sociale për fëmijët dhe të rriturit që jetojnë në varfëri, si dhe lehtësim të gjenerimit të punësimit në qytete e vogla dhe në zonat rurale, por që në Shqipëri kjo nuk ndodh. Programet e tregut të punës janë inekzistente. Jo më kot çdo ditë e më shumë të rinjtë shprehin dëshirën për t'u larguar nga

Shqipëria dhe për të mos u kthyer më kurrë, pasi ata ndjehen të vrarë shpirtërisht, të përçmuar, të pavlerësuar dhe të braktisur nga shteti dhe sistemi.

Në këtë kontekst social dhe ekonomik, rrënues të Shqipërisë, më dhemb më shumë krutani. Krutanët, njerëzit më punëtorë që njoh, më shpirtpasurit që njoh dhe më të virtytshmit jetojnë në një varfëri më të tmerrshme se kjo. Krujës, Ballkanit të fisshëm të Shqipërisë, ia kanë larguar të gjitha institucionet lokale e shtetërore drejt Durrësit dhe, më habitshëm, drejt Fushë-Krujës. Guxoj të deklaroj sot se nuk gjej justifikim tjetër për këtë izolim që po i bëhet qytetit të Krujës përveç faktit se krutanët janë të djathtë historik dhe kanë ruajtur me fanatizëm dhe besnikëri këtë bindje. Turp për maxhorancën që në vitin 2022, për shkak të votës, ndëshkon qytetarët e Krujës.

Çdo njeri e ka vizituar qytetin e Krujës, një nga më të vjetrit në gadishullin e Ballkanit, jo më shumë se 40 minuta larg nga Tirana, dhe pazarin e vjetër të Krujës, i cili krijon një urë lidhëse mes të shkuarës, të lavdishmes dhe të tashmes, duke ofruar produkte të vjetra dhe prodhime artizanale të cilësisë së lartë, por edhe pse me gjithë këto resurse Kruja është lënë në mëshirë të fatit. Teksa kalon në pazarin e vjetër të Krujës nuk sheh asnjë të ri që trashëgon artizanatin dhe kjo duket në bisedat që bëjnë me tregtarët që ndodhen aty. Takon në qytet vetëm njerëz të moshës së tretë, të cilët kërkojnë ndihmë se nuk kanë ku t'i marrin shërbimet e nevojshme. Qeveria, me pompozitet, prezantoi digjitalizimin e një sërë shërbimesh që merren online dhe pretendoi se ka ulur kostot e shtetit.

Po është e vërtetë që i ka ulur kostot e shtetit, por ka rënduar xhepat e qytetarëve shqiptarë, sepse sistemi e-Albania në pamundësi për të përballuar fluksin bllokohet dhe vonesat e krijuara kanë shkaktuar penalitete dhe kosto shtesë për bizneset e kësaj zone. Nga ana tjetër, shërbimet që ofroheshin nga zyrat, si: aplikimi për hipotekë, aplikimi për raporte, shërbimet e bizneseve të ndryshme dhe shumë shërbime të tjera sot kryhen privatisht dhe me pagesa jo të vogla në raport me të ardhurat që kanë qytetarët krutanë. Sot njerëzit në Krujë rendin të kryejnë shërbimet, por sistemi nuk punon, zyrat e shërbimit i kanë larguar nga qyteti. Më e keqja është se kur qytetarët kanë probleme shëndetësore ata nuk gjejnë mjekë specialistë, sepse nuk ka, dhe detyrohen të rendin drejt spitaleve private dhe ta lënë aty pensionin e pakët që marrin.

70% e familjeve të Krujës jetojnë me rrogë mujore 30 000 lekë në muaj. Është kaq e dhimbshme që nga një qytet largohet rinia dhe largohet mosha e mesme, për shkak se politikat shtetërore nuk u krijojnë asnjë mundësi që ata të ndërtojnë jetën e tyre në këtë qytet dhe të kontribuojnë për zhvillimin e qytetit të tyre. I vetmi punësim në qytetin e Krujës janë fasoneritë. Kruja, e cila ndodhet në çdo guidë turistike, lëngon nga vuajtjet që po i shkakton kjo qeveri. Këto janë politikat shtetërore të zhvillimit sot, kjo është Shqipëria që duam, kjo është panorama e Shqipërisë sonë sot, që, për fat të keq, është e varfër, e zymtë dhe e mjeruar. Faleminderit!